VENDIM
Nr.179, datë 19.2.2009

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1100, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR VËNIEN NË ZBATIM TË PLANIT AFATMESËM TË PROGRAMIT BRAIN GAIN, PËR PERIUDHËN 2008-2009"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në planin afatmesëm të programit Brain Gain, për periudhën 2008-2009, që i bashkëlidhet vendimit nr.1100, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të kreut 4.2, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Paketa nxitëse e programit Brain Gain, e parashikuar më lart, mund të reduktohet vetëm në mbështetje për pjesëmarrje në veprimtaritë akademike, në formë konferencash jashtë vendit (jo më shumë se dy në vit) për kandidatët, shumë të suksesshëm, në studimet universitare apo në karrierën e tyre profesionale, të cilët, me dëshirë, heqin dorë nga paketa nxitëse bazë. Ky grup kandidatësh do të emërtohet "Brain Gain Honor Fellow.".

2. Shkronja "e" e kreut 7.4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"e) Për t'u kualifikuar në skemën e paketave nxitëse, kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

i) Të jenë kthyer në Shqipëri jo më herët se data e fillimit të projektit Brain Gain (25 shtator 2006) dhe të kenë filluar marrëdhëniet e punës pas datës 1 janar 2008. Koha e kthimit në vend, e përcaktuar në këtë shkronjë, vlen edhe për kandidatët, që kanë kryer studimet e plota të doktoratës, me kohë të plotë, jashtë vendit, pa mbështetje financiare, në formë burse, nga qeveria shqiptare apo institucioni, që e ka dërguar, dhe kanë rifilluar marrëdhëniet e punës në shkollat e larta.

ii) Të kenë arritur rezultate mbimesatare në studimet e masterit, i cili ka, të paktën, 90 kredite ECTS, ku përfshihet edhe teza e masterit.

iii) Të kenë arritur rezultate mbimesatare në studimet e doktoraturës, në rastet kur vendi i punës e kërkon këtë nivel kualifikimi.

iv) T'i kenë përfunduar studimet dhe të kenë diplomën përkatëse. Diploma duhet të jetë e lëshuar nga një institucion i njohur dhe i akredituar prej organizmave akredituese, të njohura ndërkombëtarisht.

Të diplomuarit, nga programet akademike të bashkëpunimit me universitetet vendase, të tipit modular, programet akademike *on-line*, si edhe të diplomuarit nga programet akademike satelite, të ngritura jashtë vendit të origjinës së universitetit, që ka lëshuar diplomën, nuk kualifikohen për këtë skemë mbështetjeje, të arsimit të lartë.

v) Nuk duhet të jenë përfitues nga fondi i ekselencës.

vi) Nuk mund të jenë përfitues, në të njëjtën kohë, edhe nga një projekt tjetër, që mbështetet nga fonde buxhetore (p.sh. shtesa në pagë për masterin ose doktoraturën). Në këtë rast, kandidati deklaron programin, në të cilin dëshiron të kualifikohet.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha